



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008," e konform nënit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024, miratoi këtë:

## V E N D I M

Për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2023 shuma prej 554,753.52€ të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2024

### Neni 1

1.1 Komuna e Suharekës gjatë vitit 2023 ka tejkaluar planin buxhetor të të hyrave vetanake edhe për pjesën e inkasimit të denimeve të gjykatav, trafikut dhe pyjeve në shumë prej = **554,753.52€**.

1.2 Në vitin 2023, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuar, **2,193,669.00€**, ndërsa gjatë tërë vitit fiskal 2023, janë grumbulluar gjithsej shuma prej **2,748,422.52€**.

1.3 Mjetet e grumbulluara si tepriçë prej **554,753.52€** dhe shuma e pa shpenzuar që duhet bartur në vitin fiskal 2024 prej **554,753.52€** e si total i bartjes së të hyrave vetanake të tejkaluara sipa planifikimit buxhetor 2023.

1.4 Shuma prej **554,753.52€** duhet të bartet në programin SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim dhe shpenzim, në këto programe buxhetore dhe projekte kapitale.

1.5 Lista e projekteve kalitale sipas njësive buxhetore për bartje nga viti 2023 do të barten në vitin fiskal 2024 për shpenzim

**Tabela 1.**

Nr.	EMRI I PROJEKTIT	Bartja 2023
	<b>Sherbimet Publike dhe Emergjente-Infrastrukturë rrugore:</b>	<b>517,880.00</b>
1	52373 Ndërtimi i rrugës Peqan i Vogël - Semetisht	84,900.00
2	52533 Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve lokale "Sopijë-Vraniq" dhe "Reqan-Bukosh"	77,000.00
3	52714 Ndërtimi dhe rregullimi i Kolektorit në rrugën "Skenderbeu"- Suharekë	355,980.00
	<b>Arsimi Fillor :</b>	<b>36,873.52</b>
1	52396 Ndërtimi i aneksit të objektit në SHFMU "Besim Ndreca" Maqitevë	36,873.52
	<b>TOTALI :</b>	<b>554,753.52</b>



## Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet në bashkëpunim me Drejtorin për shërbime publike dhe emergjencë e Komunës së Suharekës.

## Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## Neni 4

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendim i njeiti do të shërbej për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake si tepricë të realizuara nga plani buxhetor 2023, e të cilat do të barten alokohen në SIMFK dhe shpenzohen gjatë vitit fiskal 2024.

## KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr- 016-18861  
Më datë 28.03.2024



Kryesuesi i Kuvendit

*[Signature]*  
Mr.ec Bexhet KUÇI

